



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:120952

Datë: 30.06.2023

Numri i dokumentit: 04442107

P.nr.2118/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Bujar Ahmeti, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurve: P.H. nga P., rruga ..., pa nr., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par. 1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK); dhe N.Xh., nga P., rruga ..., pa nr., për shkak të veprës penale sulmi, nga neni 184 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës me kërkesë për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1404/23, e datës 29.05.2023, jashtë seancë më datë 30.06.2023, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit, PP.II.nr.1404/23, e datës 29.05.2023, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPP-së, shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurve:

P.H., i biri i F. dhe nënës R., e gjinisë H., i lindur më datë ..., në P., me adresë banimi në rrugën ..., në P., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion tregtar, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

N.XH., i biri i S. dhe nënës Q., e gjinisë B., i lindur më datë ..., në P., me adresë banimi në rrugën, në P., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në kompaninë "E.F.", i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

I pandehuri P.H.

I. Me datën 20.12.2022, rreth orës 15:00 në rrugën ..., në P., i pandehuri P.H., pas një fjalosje verbale të atëçastshme me të pandehurin N.Xh., me dashje e me qëllim të shkakimit të lëndimeve trupore, e godet të pandehurin N.Xh. me kokë dhe boksa në pjesë të ndryshme të fytyrës, i cili si rezultat i goditjeve ka pësuar e kontuzion i kokës, të cilat paraqesin dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit.

- Me këtë ka kryer veprën penale *lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 i par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së*.

I pandehuri N.Xh.

II. Në datën dhe vendin si në dispozitivin e I-rë, i pandehuri N.Xh., pas një fjalosje verbale të atëçastshme me të pandehurin P.H., e kishte kapur një dru për ta goditur të pandehurin P.H. dhe derisa i dëmtuari E.Sh. tenton ta ndalon ku ja ka kapur drurin nga dora dhe në at moment i pandehuri N.Xh., me qëllim të sulmit dhe me dashje e përdor forcën në atë mënyrë ia kap dorën të dëmtuarit E.Sh. duke ja kafshuar gishtin.

- Me këtë ka kryer veprën penale *sulmi, nga neni 184 par. 1 të KPRK-së*.

Andaj, gjykata konform neneve 7, 8, 9, 10, 17, 21, 31, 38, 39, 43, të KPRK-së, si dhe neneve 364 dhe 495 të KPP-së, të pandehurve iu shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I.** Të pandehurit **P.H.** për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim me gjobë në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.
- II.** Të pandehurit **N.Xh.** për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim me gjobë në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.
- III.** Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje t'i paguaj dënimet me gjobë atëherë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës, do t'iu caktohet 1 (një) ditë burgim.
- IV.** Pala e dëmtuar E.Sh., me vendbanim në fshatin ..., Komuna P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- V.** Obligohen të pandehurit që secili veç e veç të paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej nga 20 € (njëzet euro), si dhe secili veç e veç shumën prej nga 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1404/23, e datës 29.05.2023, kundër të pandehurve P.H. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së dhe N.Xh., për shkak të veprës penale sulmi, nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit ka propozuar që ndaj të njëjtëve të jepet Urdhër Ndëshkimor dhe t'iu shqiptohen dënime me gjobë, me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, që vërtetojnë faktin se të pandehurit i kanë kryer veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes në kuptim të nenit 493 të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPP-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se të pandehurit i kanë kryer veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Raporti fillestar i incidentit, me numër të rastit ..., të datës 21.12.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin E.Sh. i datës 20.12.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit A.B. i datës 20.12.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin N.Xh. i datës 20.12.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin P.H. i datës 20.12.2022; ekspertiza mjekoligjore nr... e datës 23.04.2023 nga Dr. A.G., foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se të pandehurit i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimeve me gjobë ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor konform nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP-së ndërkaq vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 364 dhe 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.2118/23, datë 30.06.2023

Bashkëpunëtori Profesional,
Asdren Selmani

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.